

SHOQERIA "ECO CONCEPT" Shpk

STATUTI

Korce, Mars 2024

STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE

“ECO CONCEPT” SHPK

Sot ne daten 01.03.2024, në respektim te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise, hartojme Statutin e Shoqerise “**ECO CONCEPT**” shpk.

TITULLI I

Neni 1: Ortaket .

Ortaket themelues te shoqërisë jane:

- ❖ **Z. Erion Voda**, I biri I Bujarit, i datëlindjes 03.02.1982, lindur në Korce dhe banues në Korce, në adresën: Rruga Midhi Kostani, Korce, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i Letërnjoftimit me nr.032782628 dhe nr.personal I20203055O, me datë lëshimi 28.04.2015;
- ❖ **Mario Voda**, I biri I Ridvanit, i datëlindjes 20.06.1982, lindur në Korce dhe banues në Korce , në adresën: Pojan, Korce, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i Letërnjoftimit me nr.036519527 dhe nr.personal I20620040S, me datë lëshimi 16.10.2020;
- ❖ **Xhevair Dervishi**, I biri I Belimonit, i datëlindjes 02.06.1985, lindur në Korce dhe banues në Korce , në adresën: Biranj, Korce, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportes me nr.BR2869757 dhe nr.personal I50602035K, me datë lëshimi 15.01.2019;

Neni 2: Emri.

Emri i shoqerise eshte “**ECO CONCEPT**” Shpk. (me poshte referuar si “Shoqeria”)

Neni 3: Selia e Shoqerise.

3.1 Selia e Shoqerise eshte: **Korce, Rruga Nacionale Korce-Tirane Km5, Biranj, Zona Kadastrale 1189, Pasuria 117/17.**

3.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e R.SH., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 4: Forma ligjore

Shoqëria **"ECO CONCEPT"** eshte shoqeri shqiptare dhe eshte krijuar si **shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.**

Neni 5: Kohezgjatja.

Shoqëria ushtron veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar. Kohezgjatja e saj mund te shkurtohet me vendim te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

Neni 6: Objekti i Shoqerise.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **"ECO CONCEPT" shpk**, do të ketë për objekt aktiviteti, si më poshtë:

- *Projektim dhe zbatim të ndërtimeve energjitike, ndertimi dhe shitja e paneleve diellore, turbina ajri, turbina per hidrocentrale etj,*
- *Import-eksport i mallrave dhe materialeve industriale, paneleve voltaike, produkteve elektrike energjitike,*
- *Sherbime ne teknplogjine informatike, proramimit teknologjik dhe pajisjeve te ndryshme kompjuterike,*
- *Import-eksport i mjeteve motorike elektrike te rikarikueshme, makinave elektrike, motorrave elektrike dhe tregetimi i tyre,*
- *Tregetimi me shumice dhe pakice i arikujve te ndryshem, kancelari, aksesore e pajisje zyrash,*
- *Tregetim me shumice dhe pakice; import eksport te mallrave industriale, materieleve te ndertimit, lende te para, elektrike, hidrosanitare etj,*
- *Pjesëmarrje në projekte ndërtimore si sipërmarrës, investitor, konsulent, si dhe marrjen përsipër të menaxhimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

-
- *Import-eksport dhe tregtim (shitblerje) me shumicë e me pakicë të pajisjeve për sistem ngrohjeje, ftohjeje, ventilimi, ajrimi dhe klimatizimi. Instalim të pajisjeve për sisteme, ngrohjeje, ftohjeje, ventilimi, ajrimi dhe klimatizimi, e të tjera të këtij lloji.*
 - *Te tjera aktivitete të përgjithshme biznesi.*

TITULLI II

KAPITALI

Neni 7: Kapitali i Shoqerise

7.1 Kapitali i Shoqerise eshte: **100.000 (njqind mije) leke.**

7.2 Kapitali eshte i shlyer teresisht. Kapitali perbehet nga 3 (tre) kuota me vlerë 100.000,00 (njemije) leke
Themeluesit marrin në pronësi të tyre kuotat e kapitalit themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

7.3 Kontributi i ortakeve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

- **Erion VODA:** zotëron 80,0% te kapitalit ose 80.000 leke
- **Mario VODA:** zotëron 10,0% te kapitalit ose 10.000 leke
- **Xhevair DERVISHI:** zotëron 10,0% te kapitalit ose 10.000 leke

GJITHESEJ 100% te kapitalit ose 100.000 leke

Neni 8: Llojet e kuotave, të drejtat dhe kufizimet

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në Vendimin e Asamblese se Përgjithshme, të marre me shumicën e kualifikuar (me tre të katërtat) të votive të ortakeve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

Neni 9: Çertifikatat e kuotave të kapitalit

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e çertifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72 paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në çertifikatën e kuotës. Çertifikata nuk do të gezojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 10: Kalimi i kuotave me kontratë

(1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të percaktuara nga Administratori. Kjo kontrate do të dërgohet në seline e shoqërisë.

(2) Administratori mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës pranë QKR-së, nëse kjo kuote nuk është shlyer plotësisht ose nëse Administratori nuk është dakord me personin të cilit i kalon kuota.

(3) Nëse Administratori refuzon të regjistrojë kalimin e kuotës, ai brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

Neni 11: Kalimi i Kuotave me Trashegimi ose si pasojë e Falimentimit.

(1) Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zoterues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gezues se të drejtave mbi kuotën e tij, pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo se bashku në persona të tjera.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratori, mund të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotes në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si perfitues i kuotes. Nëse personi i mesipër zgjedh të bëhet zoterues i kuotes, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person vendos që një person tjetër të regjistrohet si zoterues i kuotes, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

(3) Personi, që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, gëzon të drejtat që gezonte zoteruesi i kuotes, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

Neni 12: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

(1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund ta zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e percaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit të saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar të votave.

Neni 13: Blerja e kuotave nga vetë shoqëria

Shoqëria mund t'i blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja nëse shoqëria përmbush kushtet për

shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligjit dhe Administratori leshon nje Çertifikatë të Aftësisë Paguese, të parashikuar nga ky nen. Ne rast se blerja e kuotave të veta nga shoqëria nuk i përmbush kushtet e Nenit 77, mund të ngrihet padi në emër të shoqërisë në përputhje me Nenet 78 dhe 79 te Ligjit.

TITULLI III ORGANET E SHOQERISE

Neni 14: Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i Shoqerise eshte Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime per:

- (1) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- (2) Ndryshimet e Statutit;
- (3) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit;
- (4) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te regjistruar;
- (5) Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likujduesin dhe ekspertin kontabel te regjistruar;
- (6) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave fianciare dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (7) Miratimin e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (8) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- (9) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tryre;
- (10) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne pretendimet ndaj administartorit;
- (11) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- (12) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese,
- (13) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 15: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Administratori thërret Asamblene e Përgjithshme, kur ta mendoje të arsyeshme vetë dhe sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një njoftimi te derguar me postë ose me poste elektronike (e-mail), që i drejtohet secilit prej ortakëve. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë Ditë të plota pune përpara dates se caktuar per mbledhjen, dhe duhet te permbaje daten, oren dhe vendin e e mbledhjes, si dhe rendin e dites.

(3) Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme te njoftimit apo mos-marrje te njoftimit te mbledhjes nga personat qe kanë të drejtën për ta marrë kete njoftim, me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise një adresë të pasaktë.

Neni 16: Punimet e mbledhjes se Asamblesë së Përgjithshme

(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Nenin 86 të Ligjit.

(2) Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.

(3) Nëse Administratori nuk dëshiron të jetë Kryetari i mbledhjes ose nëse Administratori nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.

(4) Administratori, (edhe kur nuk eshte ortak) ka te drejten e pjesmarjes si dhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Kryetari, me pelqimin e asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në mbledhjen e dyte mund te diskutohen ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, njoftimi duhet te kryhet të paktën shtatë ditë të plota perpara kesaj date dhe ne te do te përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.

(6) Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë

1. Kryetari; ose

2. Një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

(7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

Neni 17: Votat e ortakëve

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuote i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit të tij ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shprehur teresisht detyrimet që kanë të bëjnë me këto kuote.

(3) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi I të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyre do të jenë të vlefshme.

Neni 18: Votimi me Prokurë.

(1) Përfaqësuesi do të emërohet nga ortakun në formën e zakonshme apo në formën që mund të cakohet nga administratori.

(2) Çaktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vens tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sic përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes së shtyre, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 19: Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë noteriale, e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

TITULLI IV ADMINISTRATORI

Neni 20: Emërimi i administratorit

(1) Asambleja e Përgjithshme ka vendosur si administrator të Shoqërisë “ECO CONCEPT” Shpk:

- **Z. Xhevair DREVISHI.**

Administratori zgjidhet për një periudhë **pese vjeçare**, me të drejtë riemërimi në pajtim me parashikimet e shkronjës “c” të pikës 1 të Nenit 81 dhe 95 të Ligjit.

Administratori do te organizoje dhe menaxhoje te gjitha aktivitetin e Shoqerise. Ai eshte i autorizuar te perfaqesoje Shoqerine ne te gjitha ceshtjet qe kane lidhje me te. Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit burojne nga Ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme te administrimit te Shoqerise.

Administratori ka te drejtat e meposhtme:

- (a) kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- (b) perfaqeson shoqerine tregtare;
- (c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- (d) pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- (e) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne Ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- (f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- (g) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 21: Kompetencat e Administratorit

(1) Politikat tregtare te Shoqerise do te menaxhohet nga Administratori, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat qe nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas Nenit 81 i Ligjit. Ndryshimet e Statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhezimete saj nuk do te shfuqizojne aktet e meparshme te Administratorit, të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene.

(2) Administratori mund t'ua delegojë kompetencat e tij cdo komiteti i cili perbehet nga nje ose më shumë administratorë. Cdo delegim kompetencash mund te kryhet ne perputhje me kushtet qe mund te vendose Administratori dhe mund te revokohet ose ndryshohet.

Administratori nuk mund të delegoje detyrimet e tij ligjore.

Neni 22: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

(1) Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

-
- Personi nuk është me administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe Nenin 95 paragrafi (6);
 - Personi ndodhet në gjendje të paafetësisë paguese;
 - Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
 - Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë; ose
 - Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Ortakëve të Shoqërisë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe për këtë Asambleja e Përgjithshme me propozim të ortakëve vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 23: Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

(1) Administratori shpërblehet për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.

(2) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nepermjet shpërblimeve në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qene por nuk është me në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qene filiale të shoqërisë ose për shoqëri paraardhese të shoqërisë ekzistuese, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguaje kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimëve të tilla.

(3) Administratorit mund ti paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij.

Neni 24: Procesverbalet e Mbledhjeve të Asamblese

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet:

- Të gjitha takimet e kryera nga Administratori,
- Të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI V

DIVIDENTET DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE

Neni 25: Dividentet

(1) Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votive të Asamblese së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve, në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

-
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendet deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendet përpjesëtohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi. Por, në rast se kuota emetohet me kushtin e perfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
 - (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota, nuk mund të marrë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
 - (4) Cdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar votash, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

Neni 26: Kapitalizimi i fitimeve

Administratori, pas vendimit të marre nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, mund të vendosë të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashperndara të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

**TITULLI VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

Neni 27: Prishja dhe Likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i marre me shumicën e kualifikuar të votive të Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë cdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

Neni 28: Njoftimet

(1) Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund të njoftojë një ortakë personalisht ose duke i dërguar njoftimin me leter porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakët. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me Nenin 7, paragrafi (2) i Ligjit.

(3) Ky Statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunukimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te publikohen nga Administratori ne faqen e internetit te shoqerise sipas parashikimeve të Nenin 3 të këtij Statuti (nese zbatohet).

TITULLI VII DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 29:

Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 30:

Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne Republiken e Shqiperise.

Neni 31:

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Statuti mbyllet me 31 (tridhjet e nje) nene.

Ortaket Themelues te Shoqërisë Tregtare "ECO CONCEPT" shpk

Erion VODA

ERIONI VODA

Mario VODA

Mario Voda

Xhevair DERVISHI

Xhevair Dervishi